

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i parë i seancës së 26-të të Këshillit të Agjencisë
për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 19.7.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Iazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët që mungojnë të Këshillit të Agjencisë: mr. Alma Mashoviq (në pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishin: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, mr. Vladimir Gjorgjieski, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi vazhdimin e parë të seancës së 26-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski njoftoi se z-nja Mashoviq është në pushim vjetor jashtë vendit. Shpjegoi se para 2-3 orësh kanë folur në telefon dhe në atë moment ka pasur lidhje interneti ndërsa tanë supozohet se ka problem teknik. Në lidhje me Rendin e ditës tha se do të rishqyrtohet Pika 5 – Propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e letërnjoftimit zyrtar për personin e autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes, e cila ishte pezulluar.

Z. Trajçevski sqaroi se ndryshimi i Rregullores së propozuar është në drejtim të harmonizimit me disa Ligje që kanë pësuar ndryshime në periudhën e kaluar. Vërejtja e zëvendës kryetarit të Këshillit z. Ajdini ishte se pjesa e letërnjoftimit zyrtar e përkthyer në gjuhën shqipe nuk është e përshtatshme, janë bërë konsultime me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së dhe është konstatuar se vërejtjet e z. Ajdini ishin në rregull. Tani letërnjoftimi është korrigjuar dhe u propozua në këtë formë të re të miratohet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota „pro“ miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e letërnjoftimit zyrtar për personin e autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrën e dhënies dhe marrjes së saj, me tekstin siç ishte propozuar.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përpiloi tekst të zbardhur të aktit nënligjor të mësipërm.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Rregulloren e mësipërme ta publikojë në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Nr. 02-2732/10

27.07.2022
Shkup

Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v